BASEL LANDSCHAFT
VOLKSWIRTSCHAFTS- UND GESUNDHEITSDIREKTION
AMT FÜR GESUNDHEIT

# UDHËZUES «Shtatzëne pa dëshiruar atë?»

## Ju keni të drejtë për këshillime - pa pagesë, me besueshmëri, neutrale

Një shtatzëni e paplanifikuar mund të hap shumë pyetje të reja dhe të shkakton ndjenja kontradiktore. Sipas ligjeve federale Ju në situatë të tillë keni të drejtë për këshilla profesionale dhe mbështetje pa pagesë, pavarësisht nga ajo, se a doni Ju ta mbani shtatzëninë deri në fund apo ta ndërprenë.

Nëse Ju gjendeni në një situatë konflikt të tillë, për vendimmarrje personale ju nevojitet edhe një kohë e caktuar apo Ju dëshironi të keni biseda pa rezultate mbi situatën Tuaj personale, atëherë drejtohuni te zyrat oficiele kantoni për këshillime, të cilat Juve do ju ndihmojnë më tutje për çështjet sociale, psikologjike, financiare dhe ligjore.

Një këshillim i tillë Juve do ju mbështesë mbi atë, se si të konstatohet vendimi i vërtetë për Ju. Nëse Ju dëshironi, në këto këshillime mund të shkoni gjithashtu edhe me partnerin, partneren apo personin Tuaj referent të afërt.
Përfundimisht, vetëm Ju gjendeni në atë situatë të vendosni për apo kundër mbajtjes së plotë të shtatzënisë.
Sie Këtë zyrë këshillimi Ju mund ta vizitoni edhe pas kryerjes së ndërprerjes së shtatzënisëapo edhe në lidhje me çështje kontracepsioni.

## Ju keni vendosur ta ndërprisni shtatzëninë

Në këtë rast mjekja, mjeku Juaj ka zhvilluar biseda të gjëra informative dhe ju ka informuar me rregulloret ligjore, rrjedhën e procedurës mjekësore, si dhe mbi rreziqet shëndetësore.

Sipas ligjit, vendimin Tuaj duhet ta dëshmoni përmes nënshkrimit Tuaj dhe me këtë Ju paraqisni kërkesën për ndërprerje shtatzënie.

## Ju jeni më e re se 16 vjeçare

Në këtë rast Ju, pranë bisedave mjekësore, duhet t'i drejtoheni edhe një zyre të specializuar këshillimi për shtatzëne të moshës rinore.

Ky këshillim në besueshmëri pa pagesë për të rejat nën 16 vjeçare është **i obligueshëm**.

BASEL LANDSCHAFT

## Ju gjendeni në një situatë urgjence?

Ju jeni në atë gjendje, që askush të mos njoftohet mbi shtatzëninë dhe lindjen Tuaj: në spital Ju do keni një emër të fshehtë gjatë shtatzënisë, para dhe pas lindjes, si dhe do keni këshillime mjekësore dhe psikologjike. Ju mundeni të lindni fëmijën Tuaj në besueshmëri, ashtu që rrethi Juaj të mos ketë njohuri mbi lindjen. Në gjendjen civile kjo lindje do lajmërohet si«lindje konfidenciale», obligimi i lajmërimit automatik tek organet për regjistrim të banorëve nuk do realizohet. Me këtë garantohet, që emri i nënës do mbetet i fshehët.

## Adoptimi

Dhënia e një fëmije të lirë për adoptim menjëherë pas lindjes, është një vendim i vështirë, i cili kërkon mendime dhe biseda parimisht të thella.

Për këtë Juve ju qëndrojnë në dispozicion zyrat oficiele për këshilla apo zyra për fëmijë nën përkujdes dhe të adoptuar Zvicra. www.pa-ch.ch

## Adresat

Për një bisedë të menjëhershme gjatë krizës Ju, çdo ditë brenda njëzetekatër orëve, mund t'i drejtoheni **numrit të telefonit 143**.

Zyrat oficielee kantonit për këshilla, Zyra Profesionale Shëndeti seksual dhe Zyrat Këshillimi për të rinj nën 16 vjeç: www.bsb-bl.ch

Beratungsstelle Binningen
(Qendra e këshillimit Binningen)
Hauptstrasse 85 A
4102 Binningen
Tel: 061 413 24 00
binningen@bsb-bl.ch

Beratungsstelle Liestal
(Qendra e këshillimit Liestal)
Rathausstrasse 6
4410 Liestal
Tel: 061 921 60 13
liestal@bsb-bl.ch

## Tjera

Ambulatorium Frauenklink Kantonsspital Baselland, Liestal
(Klinika ambulatore, klinikë gjinekologjike, Spitali Kantonal Baselland, Liestal)
Tel: 061 925 22 04, www.ksbl.ch

APAC, praktische Informationen über den Schwangerschaftsabbruch
(Informata praktike për ndërprerje shtatzënie)
www.schwangerschaftsabbruch.org

Stelle für Pflege- und Adoptivkinder Schweiz
(Zyra për fëmijë nën përkujdes dhe të adoptuar Zvicra)
www.pa-ch.ch